



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____ /2021

Dt. 26.03.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 27 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Pa luajtshme Komunale, nenin 41 pika a dhe h të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.03.2021, pas diskutimeve lidhur me pikën e 3 të Rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e parcelës për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionist” në Komunën e Gjakovës , e miratoi këtë:

V e n d i m

1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e “Qendrës Ditore për Pensionist” në Komunën e Gjakovës në pjesën e parcelës nr. P.707050077-00107-0 në Zonën Kadastrale Firzë .
2. Parcela e lartcekur ka sipërfaqe të përgjithshme prej 81132.0m² dhe në të njëjtën parcelë janë ndërtuar Terrenet e Tenisit dhe fusha Sintetike e futbollit .
3. Qëllimi i ndarjes së parcelës është ndërtimi i “Qendrës Ditore për Pensionist“, ndërsa investimet do të bëhen nga Komuna e Gjakovës sipas projektit ideor .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

5.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala